Nr.11243-00612-00-2009 i Regj. Themeltar
Nr.00-2014-520 i Vendimit (45)

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian Nuni	Kryesues
Majlinda Andrea	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Admir Thanza	Anëtar
Artan Broci	Anëtar

Në seancën gjyqësore të datës 13.02.2014 mori në shqyrtim çështjen civile që i përket:

KËRKUES:	ITALSTRADE IS S.R.L
PERSON I INTERESUAR:	KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË. MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT, TELEKOMUNIKACIONIT (DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE)

OBJEKTI:
Dhënie fuqi ligjore dhe njohje e vendimit përfundimtar të Arbitrazhit datë 14/02/2006 të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit në lidhje me çështjen ICC nr.13205 FM ndërmjet "Italstrade" S.P.A. dhe Republikës së Shqipërisë.
Baza Ligjore: Neni 393-399 të K.Pr.Civile.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.16, datë 23.02.2009, ka vendosur:

"Pranimin e kërkesës.
Njohjen dhe dhënien fuqi ligjore për zbatim në Republikën e Shqipërisë, të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit, datë 14 Shkurt 2006, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit në lidhje me çështjen ICC nr.13205-Fm, ndërmjet "Italstrade" S.p.a., dhe Republikës së Shqipërisë."

Kundër këtij vendimi, ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, Avokatura e Shtetit, me anë e të cilit ka kërkuar, prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me tjetër trup gjykues, duke parashtruar edhe shkaqet përkatëse:

- Pala kërkuese ka dështuar në sigurimin e një vendimi origjinal apo kopje të legalizuar në mënyrën e duhur dhe të përkthyer nga një përkthyes zyrtar në kuptim të nenit 4/1/a

dhe nenit 4/2 të Konventës së New York dhe si rrjedhojë, gjykata e apelit ka dhënë një vendim të bazuar në një dokumentacion të pavlefshëm, duke shkelur rëndë rregullat procedurale parashikuar nga neni 467/e i K.Pr.C-së.

- Pala kërkuese ka dështuar në sigurimin e një kopje origjinale të kontratës (neni 67), në bazë të së cilës palët kanë rënë dakord që çdo mosmarrëveshje ta zgjidhin përmes Arbitrazhit Ndërkombëtar, si dhe përkthimin.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Majlinda Andrea; dëgjoi Avokatin e Shtetit, i cili pasi pohoi arritjen e marrëveshjes dhe shlyerjen e detyrimit e la zgjidhjen e çështjes në çmim të gjykatës; dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore rezulton se Shoqëria Italstrade IS S.R.L, person juridik Italian, ka vënë në lëvizje Gjykatën e Apelit Tiranë, duke i drejtuar kërkesën për dhënie fuqi ligjore dhe njohjen e vendimit përfundimtar të dhënë më 14 Shkurt 2008 nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë *(ICC),* Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit, në lidhje me çështjen ICC, nr.13205, FM, ndërmjet Italstrade S.p.a, si palë paditëse dhe Republikës së Shqipërisë, palë e paditur.

2. Sipas këtij vendimi rezulton se, Republika e Shqipërisë, është urdhëruar t'i paguajë Shoqërisë Italistrade S.p.a, shumën prej 3.362.968,50 Euro plus 7.7% interes në vit, deri në ditën e pagesës, që i përkasin periudhës nga data 19.04.2001 deri në datën 16.03.2004. Rimbursimin nga Republika e Shqipërisë, në favor të Shoqërisë Italstrade S.p.a., të shumës prej 140.000 USD që përben 50% të shpenzimeve të Arbitrazhit të përcaktuar nga gjykata ICC, 7.7%, interes në vit mbi këtë shumë, duke filluar nga data e shpalljes së këtij vendimi, deri në ditën e rimbursimit.

3. Shqyrtimi në themel dhe gjykimi i çështjes është bërë në Qytetin e Tiranës nga tre arbitra, njëri nga të cilët shqiptar, z.Neritan Kallfa. Shteti shqiptar është përfaqësuar në gjykim me zotërinjtë Artur Luca, Drejtor i Njësisë për Menaxhimin e Programit dhe Dr.Shefqet Muci, avokat i Shtetit.

4. Vendimi i objekt kërkimi, për dhënie fuqi ligjore dhe njohje nga Republika e Shqipërisë, nuk është kundërshtuar nga pala shqiptare me asnjë mjet ligjore përfshi dhe për pavlefshmëri të këtij vendimi. Përfaqësuesit e palës kërkuese kanë parashtruar se, gjykimi në Gjykatën e Arbitrazhit është bërë konform proceduarve të përcaktuara në ligj.

5. Vendimi nuk është kundërshtuar nga përfaqësuesit e palës shqiptare në shqyrtimin e themelit të këtij gjykimi nga zotërinjtë Artur Luca dhe Avokati i Shtetit Dr.Shefqet Muçi, përfaqësues të palës gjyqhumbëse. Lidhur me dokumentet e paraqitura në këtë gjykim, kontestimit të përkthyesit nga pala e tretë, pala kërkuese ka paraqitur listën që përkthyesi Adela Kore është e licencuar si e tillë.

6. Përfundimisht, përfaqësuesit e Shoqërisë Italstrade IS S.r.l kanë kërkuar pranimin e kërkesës. Përfaqësuesit e Avokaturës së Shtetit, të pranishëm në gjykim, kanë parashtruar se Gjykata e Arbitrazhit gjatë shqyrtimit të çështjes ka dalë jashtë kompetencave, nuk ka marrë në konsiderate disa pretendime të palës shqiptare, duke shkelur procedurat lidhur me vlerësimin e dëmit të shkaktuar. Gjykata nuk mori ekspert, si dhe autentitetet dokumentare

janë nga përkthyes i palicencuar. Përfundimisht kërkuan nga gjykata rrëzimin e kërkesës për dhënie fuqi ligjore dhe njohje të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

7. Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.16, datë 23.02.2009, ka vendosur: "*Pranimin e kërkesës. Njohjen dhe dhënien fuqi ligjore për zbatim në Republikën e Shqipërisë të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit, datë 14 Shkurt 2006, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit në lidhje me çështjen ICC nr.13205-Fm, ndërmjet "Italstrade" S.p.a., dhe Republikës së Shqipërisë*".

8. Kundër këtij vendimi, ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë Avokatura e Shtetit, me anë e të cilit ka kërkuar, prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me tjetër trup gjykues, duke parashtruar shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Ligji i zbatueshëm

9. Ligji nr.8588, datë 15.03.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, në të cilat përcaktohet se:

9.1. Neni 12, i ligjit nr.8588, datë 15.03.2000, në të cilin përcaktohet se:

"Kolegjet e Gjykatës së Lartë gjykojnë ankimet për çështje gjyqësore sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurës Penale."

9.2. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, neni 442: "*Mjetet për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave janë: Ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë, kërkesa për rishikim."*

Neni 442/b: "*Rekursi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose të apelit në Gjykatën e Lartë, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.*"

Neni 472: "*Vendime ndaj të cilave mund të ushtrohet rekurs "Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur:*

a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji;

b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi)".

III. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson

10. Se nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore dhe deklarimet e palëve gjatë seancave në Gjykatën e Lartë, rezulton se palët ndërgjyqëse, pra pala kërkuese Italstrade IS S.r.l. dhe pala e interesuar Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve), pas dhënies së vendimit nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë, nr.16, datë 23.02.2009, kanë arritur një Marrëveshje Negocimi.

11. Faktin e arritjes së kësaj marrëveshje e kanë pohuar përfaqësuesit e të dyja palëve, në seancat gjyqësore të datave 24.05.2011 dhe 28.06.2011.

12. Palët kanë pranuar se kanë rënë dakord për mënyrën e vënies në ekzekutim të vendimit të gjykatës së apelit, nëpërmjet marrëveshjes jashtëgjyqësore, arritur pasi është nxjerrë Urdhri i Kryeministrit nr.33, datë 18.03.2011. Marrëveshja është nënshkruar nga të dyja palët dhe është paraqitur një fotokopje e noterizuar nga palët.

13. Në seancën e fundit, përpara Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Avokati i Shtetit ka deklaruar se me VKM nr.746, datë 12.10.2011, është vendosur ekzekutimi i vendimit nr.13205-FM, datë 14.02.2006 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, në vlerën 4.000.000 euro, vlerë për të cilën është rënë dakord sipas marrëveshjes së negocimit. Me anë të këtij vendimi është përcaktuar se fondi i pagesës do të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit për vitin 2012 dhe është përcaktuar dhe institucioni që do të ngarkohej për zbatimin e kësaj VKM. Vendimi ka hyrë në fuqi menjëherë.

14. Ndodhur në kushtet kur ndërmjet palëve ka një marrëveshje negocimi të datës 7 Prill 2011 për mënyrën e ekzekutimit të vendimit, që përcakton dhe vlerën e detyrimit që shteti shqiptar do t'i paguajë kërkuesit Italstrade IS S.r.l., si dhe është përcaktuar më pas me VKM nr.746, datë 12.10.2011 "Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit për çështjen nr.13205-fm, Italstrade S.P.A. kundër Republikës së Shqipërisë", nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmohet se nuk ka më objekt shqyrtimi të kësaj çështje, pasi Shteti Shqiptar ka njohur detyrimin e vendimi të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe ka vendosur ekzekutimin e tij.

15. Ky Kolegj arrin në këtë përfundim, duke u bazuar dhe në pretendimet e palës rekursuese, Avokaturës së Shtetit, përfaqësuesi i së cilës ka paraqitur VKM nr.746, datë 12.10.2011 dhe nuk ka kërkuar të shqyrtohen shkaqet e rekursit, por ka deklaruar se e lë në çmim të trupit gjykues se si do të konkludojë për vazhdimin e çështjes.

16. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke qenë në kushtet e mungesës së lëndës për shqyrtimin e rekursit, për shkak se vendimi i gjykatës së apelit i kundërshtuar me rekurs është pranuar të zbatohet vullnetarisht nga pala shqiptare (e cila ka ushtruar dhe rekursin), çmon se duhet të pushohet gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485 të K.Pr.Civile,

V E N D O S I

Pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

Tiranë, më 13.02.2014